



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2020:033437
Datë: 10.05.2024
Numri i dokumentit: 05667879

C.nr.177/08

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri në çështjen juridike kontestimore të paditëses Agjencia Pyjore e Kosovës-zyra në Prizren të cilën me autorizim e përfaqëson H.S.-G., zyrtare për çështje juridike DKR-APK Prizren, kundër të paditurit M.B. M. nga fshati A./Malishevë, me objekt kontesti për kompensim dëmi, vlera e kontestit 188.16 euro, duke vendosur për kthimin në gjendjen e mëparshme, jashtë seance me datë 10 maj 2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. **REFUZOHET** propozimi për kthimin në gjendjen e mëparshme, i ushtruar me datë 19.05.2015 nga paditësja-Ministria e Drejtësisë/Agjencia Pyjore e Kosovës-zyra në Prizren.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr.177/08 të datës 16.04.2015 është konsideruar e tërhequr padia e paditëses Ministria e Drejtësisë/Agjencia Pyjore e Kosovës-zyra në Prizren, kundër të paditurit M. M. nga fshati A./Malishevë për shkak të mos prezantimit në seancën gjyqësore të datës 16.04.2015 nga e autorizuar e paditëses, aktvendim të cilin paditësja e ka pranuar me datë 15.05.2015.

Paditësja me dt.19.05.2015, ka ushtruar propozim për kthim në gjendjen e mëparshme me arsyetimin se nuk kanë pasur mundësi të marrin pjesë në seancën e datës 16.04.2015 prej orës 10:30 për shkak të volumit të madh të punës dhe numrit të madh të seancave të caktuara për atë datë dhe po ashtu se në të gjitha palët ku palë në procedurë është Agjencia Pyjore e Kosovës prezanton vetë Agjencia, konkretisht zyrtarja H.S.-G.,dhe po ashtu ka theksuar se janë njoftuar nga Agjencia Pyjore e Kosovës se nga gjykata nuk kanë pranuar asnjë ftesë për datën 16.04.2015, prandaj duke u bazuar në këtë, ka qenë i pamundur prezantimi i zyrtarit nga Ministria e Drejtësisë në rastin C.nr.177/08 me datën 16.04.2015.

Duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë më lart, përfaqësuesi i të paditurës ka kërkuar nga gjykata që të veprohet konform dispozitës së nenit 129 të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe ka propozuar që gjykata të lejoj kthimin në gjendjen e mëparshme.

Siç rezulton nga procesverbali i kësaj gjykate i datës 16.04.2015 me fillim prej orës 11.00, gjykata ka konstatuar se në seancën përgatitore të së njëjtës datë nuk ka prezantuar i/e autorizuar e paditëses edhe pse ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt, me çka është dëshmuar nga fletë kthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës, mirëpo Ministria e Drejtësisë/paditësja, edhe pse fletë kthesën e ka pranuar në mënyrë të rregullt me datën 30.03.2015, ajo mungesën nuk e ka arsyetuar. Gjithashtu në seancë nuk ka prezantuar as i padituri për të cilin në shkresat e lëndës thuhet se e ka ndërruar vendbanimin (jeton në P.).

Në po të njëjtën datë, pra me datë 16.04.2015, gjykata në seancë gjyqësore ka nxjerrë aktvendim ku padinë e paditëses-Agjencia Pyjore e Kosovës-zyra në Prizren, e ka konsideruar si të tërhequr.

Gjykata, pasi e ka shqyrtuar parashtrësën/kërkesën e paditëses për kthim në gjendjen e mëparshme dhe pas vlerësimit të të gjitha pretendimeve, gjeti se parashtrësja e dorëzuar në gjykatë me datë 19 maj 2015 është e pabazuar pasi që sipas dispozitës ligjore të nenit 129 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se: *“Në qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humb afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humb të drejtën që më vonë të kryej veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t’i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj të kryej me vonë këtë veprim, po që se konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen”*, ndërsa në rastin konkret nuk ekziston asnjë shkak i arsyeshëm të cilin gjykata do të mund ta pranonte kërkesën për lejimin e kthimit në gjendjen e mëparshme.

Arsyetimi se nuk kanë pasur mundësi të marrin pjesë në seancën e datës 16.04.2015, për shkak të volumit të madh të punës dhe numrit të madh të seancave të caktuara për datën e njëjtë, gjykata nuk e mori parasysh, për arsye se i autorizuar i paditëses edhe pse me kohë dhe në mënyrë të rregullt është njoftuar për seancën e datës 16.04.2015, ai nuk ka kërkuar paraprakisht shtyrjen e seancës dhe nuk ka ofruar as edhe një provë të vetme se kanë qenë të zënë në seanca tjera.

Arsyetimi tjetër se Agjencia Pyjore e Kosovës nuk ka pranuar ftesë për datën 16.04.2015, po ashtu është i pabazuar sepse siç u tha më lart, në bazë të shkresave të lëndës, ftesën në mënyrë të rregullt dhe me kohë e ka pranuar i/e autorizuar nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura shtetërore me datën 30.03.2015 dhe ky dërgim i ftesës është bërë bazuar në Ligjin nr.04/L-157 për Avokaturën Shtetërore.

Lidhur me të gjitha këto, gjykata konsideron se nuk janë plotësuar kushtet për kthim në gjendjen e mëparshme, përkatësisht nuk ka ndodhur ngjarje apo rrethanë e paparashikuar për ta penguar të autorizuarin e paditëses që të prezanton në seancën e datës 16.04.2015, për çka edhe propozimin për kthim në gjendjen e mëparshme e ka refuzuar si të pabazuar.

Nga të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi bazuar në nenin 129 dhe 130, lidhur me nenin 387.1 pika (k) të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.177/08, datë 10.05.2024

Gj y q t a r i
Petrit Curri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.